

VENDIM
Nr. 536, datë 8.7.2020

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 47, DATË 22.1.2020,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E
NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË TË PËRKOHSHME, PËR VITIN
2020, NË NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 12, të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 47, datë 22.1.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 1, numri i punonjësve me kontratë të përkohshme ndryshohet dhe bëhet 2 278 (dy mijë e dyqind e shtatëdhjetë e tetë) veta.

2. Në lidhjen nr. 1, të përmendur në pikën 1, në ndarjet “Gr. 05, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural”, “Gr. 10, Ministria e Financave dhe Ekonomisë”, “Gr. 14, Ministria e Drejtësisë”, “Gr. 15, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme” dhe “Gr. 87, Institucione të tjera qeveritare”, shtohen nëndarjet sipas tabelës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Në ndarjen “Gr. 05, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural” periudha kohore për 2 punonjësit manovratorë dhe 3 punëtorë të mirëmbajtjes së zgarës së Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Durrës bëhet 6-mujore.

II. Ngarkohen institucionet e përmendura në këtë vendim që të depozitojnë pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë detajimin e numrit të punonjësve me kontratë, periudhën kohore të punësimit dhe kategorinë përkatëse të pagës së tyre.

III. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Drejtësisë, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Shkolla Shqiptare e Administratës Publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Gr.	Emri i Institucionit		Emërtesa	Koha mesatare ditore	Periudhë kohore
5	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	1			
	Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë	1	Specialist	8 orë/ditë	5 muaj
10	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	6			
	Inspektoriati Shtetëror i Mbikqyrjes së Tregut	5	Operatorë	8 orë/ditë	6 muaj
	Inspektoriati Shtetëror i Mbikqyrjes së Tregut	1	Specialist	8 orë/ditë	6 muaj
14	Ministria e Drejtësisë	1			
	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës	1	Sanitare	8 orë/ditë	6 muaj
15	Ministria Për Evropën dhe Punët e Jashtme	3			
	Aparati	3	Specialist	8 orë/ditë	6 muaj
87	Institucione të tjera qeveritare	2			
	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike	2	Specialist	8 orë/ditë	6 muaj
	TOTAL PUNONJËS ME KONTRATË	13			